



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:147704 **C. nr. 1370/2021**
Datë: 12.12.2022
Numri i dokumentit: 03741890

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional H.E. në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit R.M. nga Prizreni, të cilën me autorizim i përfaqëson avokati V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – DKA, për kompensimin e shujtave, jashtë seance, me datë 12 Dhjetor 2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M
(pa shqyrtim kryesor)

MIRATOHET, si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.M. nga Prizreni, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që t'i paguan paditësit R.M. nga Prizreni, në emër të kompensimit të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë shumën 298,00 € për 149 ditë pune, nga 2,00 € për ditë pune, për periudhën kohore nga data 01.11.2020 deri më 30.06.2021. Si dhe shumën prej 452,00 € për 226 ditë pune nga 2,00 € për ditë pune, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 deri më 30.06.2022, me kamatë vjetore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë 07.07.2021, e deri në përmbushjen definitive. Si dhe t'i kompenson shpenzimet e procedurës në shumën 124,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi kundër Komunës së Prizrenit me të cilën ka kërkuar që në emër të shujtave të papaguara të cilat ju takon sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, të kompensohet paditësit R.M. për 298.00 € dhe atë për periudhën prej 1 nëntorit 2020 deri më datën 30 qershor 2021, ka gjithsejtë 149 ditë pune të pa paguara nga 2.00 €, në ditë, gjithsejtë për pagesë 298 euro.

Paditësi i ka bashkangjitur provat materiale vërtetimin për ditët e punës të lëshuara nga SHFMU “Mati Logoreci” në Prizren.

Nga theksimet e paraqitura në padi theksohet se paditësi është në marrëdhënie pune në Shkollën e Filllore e Mesme e Ulët “Mati Logoreci” në Prizren, dhe se nuk janë paguar shujtat ditore në lartësi prej 2 (dy) euro në ditë. Sipas të autorizuarit të paditësit bazuar në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, datë 18.04.2017 dhe 22.01.2021 thuhet se *“Të punësuarave u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të*

rregulluar ushqimin e të punësuarave përmes restorantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim ”.

Në bazë vërtetimit të ditëve të punës të lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme të Ultë “Mati Logoreci” paditësi, gjatë periudhës prej 1 nëntorit 2020 deri më datën 30 qershor 2021, ka këto ditë pune të pa paguara, ku përfshin prej 149 ditë pune të pa paguara nga dy euro në ditë, gjithsejtë shumën e përgjithshme prej 298.00 €.

Ka propozuar miratimin e kërkesëpadisë. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës sa do që bëhen deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje.

Pala e paditur në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Ka theksuar se paditësi është thirrur në dispozitat nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, pa dëshmuar se është anëtare të Sindikatës së Arsimit të Kosovës – SBASHK.

Po ashtu sipas të autorizuarit të paditurës ky lloj shpërblimi mundësohet një vlerësim më të mirë të figurës së mësimdhënësit, ndërsa në këtë rast paditësi nuk është mësimdhënës por punëtor ndihmës në shkollë dhe rrjedhimisht kërkesa për kompensimin e shujtës ditore nuk ka bazë.

Gjithashtu nuk ka paraqitur prova tjera për shterjen e gjitha mjeteve juridike, që kanë kaluar në procedurën administrative, sepse nuk kanë ushtruar ankesë në Inspektoratin e Punës, siç parashihet në nenin 82 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës.

Po ashtu, sipas tyre Qeveria e Kosovës është garantuese për implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe se Ministria e Arsimit është dashur të fillon realizimin e të drejtave që dalin nga KKAK, duke planifikuar buxhet në bashkërendim me Ministrinë e Financave, po e cila nuk e ka caktuar kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Kontrata Kolektive, ashtu që Komuna e Prizrenit rrezikon planifikimin buxhetor dhe në këtë mënyrë nuk mund të vepron në kundërshtim me ligjin për Buxhet, sa i përket tejkalimeve buxhetore të planifikuara për vitin 2022.

Si dhe sipas tyre marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Andaj, bazuar në këto fakte, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit të refuzon, në tërësi si të pabazuar.

Gjykata gjatë ekzaminimit të shkresave të lëndës dhe vërtetimit të lëshuara nga SHFMU “Mati Logoreci” në Prizren, vërtetohet se paditësi R.M. gjithsejtë ka pasur 298 ditë pune aktive, dhe atë për periudhën prej datës 1 nëntor 2020 deri më 30 qershor 2021.

Në kuptim të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, punëtorëve të arsimit ju njihet e drejta në kompensim të shpenzimeve të ushqimit në punë për një ditë pune të pranishme në punë në shumën 2.00 €, me kusht që punëdhënësi të mos ketë të organizuar përmes restorantit apo kuzhinës në vendin e punës.

Në rastin konkretë paditësi R.M. është vërtetuar se, gjatë periudhës prej 1 nëntorit 2020 deri më 30 qershor 2021, ka qenë e pranishme me punë 149 dite pune, ashtu që nga 2.00 € në ditë për 149 ditë, gjithsejtë ka të drejtën të kompensohet në shumën prej 298.00 €.

Në kuptim të nenit 152 të LPK-së gjykata pa shqyrtim kryesor mund të jep aktgjykim me kusht që pala e paditur t'i pohon faktet pavarësisht kundërshtimit të kërkesëpadisë. Në rastin konkretë pala e paditur e pohon faktin që sipas kontratës Kolektive të Arsimit, të punësuarit kanë të drejtë në kompensim. Gjithashtu pohon faktin që paditësi është punëtor dhe ka qenë i pranishëm në punë gjatë periudhës prej 1 nëntorit 2020 deri më 30 qershor 2021. Si dhe faktin që për ato ditë nuk është kompensuar. Pavarësisht se e kundërshton kërkesëpadinë me arsyetimin që Komuna nuk ka detyrim që të kompenson këtë të drejtë pasi që nuk ka qenë nënshkruese e asaj kontrate.

Gjykata ka vlerësuar kundërshtimin e palës së paditur, mirëpo ka gjetur se me ligj është përcaktuar kush duhet të jetë nënshkrues i asaj kontrate dhe pavarësisht që punëdhënësi konkretë Komuna e Prizrenit nuk është nënshkrues, ka detyrim të zbatimit të asaj kontrate, pasi që emër të Komunës së Prizrenit, në rastin konkret, atë kontratë e ka nënshkruar Qeveria e Kosovës. Se si bëhet alokimi nga buxheti qendrorë i Republikës së Kosovës për pagesën e atyre detyrimeve të marr sipas Kontratës Kolektive të Arsimit, për përfituesit e të drejtave që rrjedhin nga ajo kontratë, nuk është me rendësi. Kjo çështje nuk mund të jetë pengesë që punëtori i arsimit të mos kompensohet për të drejtat që i takojnë sipas asaj kontrate.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e miratuar shumën përkatësit dhe duke llogaritur kamatën ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë 07.07.2021.

Për shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, pasi që pala e paditur ka humbur, ashtu që detyrohet pala e paditur që palëve paditëse t'ia paguaj në emër të përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 € dhe në emër të takës gjyqësore në shumën prej 20.00 €, gjithsejtë në shumën prej 124.00 €.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
C. nr. 1370/2021 datë 12 Dhjetor 2022

B. profesional
Hilmi Elshani

Gj y k a t ë s i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.